

28.02.2026

AIDA

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	12.01.2026	Më 25 qershor 2025, përmes shkresës me Nr. Prot 1385/1, Drejtoria e Investimeve Strategjike pranë AIDA-s, na ka thënë se Komiteti i Investimeve Strategjike ka ngritur prej datës 10 janar 2025 grupin e negocimit të marrëveshjes [...] në përgjigje thuhej se "aktualisht grupi është në proces negocimi". Nisur nga fakti se ka kaluar	15.01.2026	Referuar kërkesës suaj për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumenteve / informacioneve zyrtare në lidhje me propozimin për të investuar në [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] pasi pretendohet se ka spekulime se drejtuesi i kësaj kompanie është tërhequr ngainvestimi, ju informojmë si më poshtë vijon: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) po ndjek me prioritet procesin e negociatave me qëllim finalizimin e Projektit të Investimit [REDAKTUAR] të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike, duke zhvilluar takime të vazhdueshme mepërfaqësues të institucioneve respektive që janë pjesë e Grupit të Negocimit, dhe nuk kemi asnjë njoftim të [REDAKTUAR] për tërheqje ngainvestimi, siç pretendohet.	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		rreth një vit nga nisja e këtyre negociimeve dhe spekulimeve se drejtuesi i kompanisë [REDACTED] është tërhequr nga investimi do të donim të kishim informacione zyrtare për pyetjet sa më poshtë: 1. Cili është statusi aktual i procesit të negociimit me [REDACTED] në janar 2026? 2. A ka pasur njoftim zyrtar për tërheqje nga kompania [REDACTED]? Nëse po, në cilën datë, në çfarë forme dhe çfarë arsyeimi? 3. A është mbyllur, pezulluar apo vazhdon ende procesi i negociimit i nisur në janar 2025? 4. A ka pasur mbledhje të grupit negociator pas qershorit 2025? Sa mbledhje janë zhvilluar dhe kur? 5. A ka pasur interesime të tjera për				
--	--	--	--	--	--	--

		zhvillime dhe investime në [REDACTED] për shembull nga kompani dhe investitorë shqiptarë? Nëse po, cili është statusi i këtyre interesimeve? 6. A është përgatitur ndonjë raport përfundimtar ose ndërmjetës mbi ecurinë apo dështimin e negociatave për projektin e investimeve në [REDACTED]				
2.	26.01.2026	Në vijim të përgjigjes suaj të datës 15 janar 2026, ku na keni informuar se <i>AIDA po ndjek me prioritet procesin e negociatave për projektin</i> [REDACTED] duke zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues të institucioneve respektive që janë pjesë e Grupit të Negocimit, dhe duke	05.02.2026	Në vijim të kërkesës suaj të datës 26 janar 2026, me anë të së cilës kërkon informacion mbi veprimtarinë e Grupit të Negocimit për projekt-propozimin [REDACTED] ju bëjmë me dije se ky proces po zhvillohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për investimet strategjike. Referuar parashikimeve të pikës 14 të Vendimit Nr. 23, datë 30.12.2024 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), si dhe Urdhrit të Kryetarit të KIS Nr. 6, datë 10.01.2025, është ngritur Grupi i Negocimit të Marrëveshjes (GNM) i cili ka në përbërje përfaqësues nga Korporata Shqiptare e Investimeve (AIC), Aparati i Zëvendëskryeministrit, Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Aparati i Ministrisë së Financave, Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e	E plotë	Nuk ka

		marrë shkas nga përgjigjet e marra nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit, si dhe Korporata e Investimeve Shqiptare, të cilat na adresojnë te ju për informacion, paraqesim këtë kërkesë në ushtrim të së drejtës së garantuar nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Duke qenë se AIDA vepron në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike, kërkojmë informacion faktik dhe të dokumentuar mbi aktivitetin e zhvilluar deri më sot. Konkretisht, kërkojmë: 1. Listën zyrtare me emra të anëtarëve të Grupit të Negocimit,	Turizmit dhe Mjedisit, [REDAKTUAR] si dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Përbërja e këtij grupi është përcaktuar mbi baza institucionale për të garantuar që negociata të zhvillohet brenda kuadrit ligjor të investimeve strategjike dhe parashikimeve të VKIS Nr. 23, datë 30.12.2024. Lidhur me ecurinë e takimeve dhe logjistikën e tyre, ju informojmë se afati i dhënë në dispozicion të kësaj negociate ishte deri më datë 13 nëntor 2025, por me dakordësi të palëve, kërkesa për shtyrjen e këtij afati është përcjellë për vendimmarrje nga Sekretariati Teknik në KIS. Aktualisht pritet zbardhja e vendimit dhe publikimi i detajeve të mëtejshme, pasi siç ju është bërë me dije edhe më parë, ky është një proces administrativ, vendimmarrjet mbi të cilin zbardhen nëpërmjet akteve zyrtare që bëhen publike dhe janë të aksesueshme nga kushdo pas përfundimit të fazave përkatëse. Sa i përket pretendimeve për përfshirjen e zonave të tjera, sqarojmë se procesi i ndjekur sipas legjislacionit të investimeve strategjike përfshin vetëm projektin për të cilin është aplikuar zyrtarisht dhe jo projekte të tjera. Çdo detaj mbi përfaqësimin e palës propozuese apo elementet e bashkëpunimit local, administrohen në kuadër të dokumentacionit zyrtar të negociatave, i cili mbetet pjesë e dosjes administrative deri në zyrtarizimin e plotë të marrëveshjes. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit		
--	--	--	---	--	--

		sipas aktit të ngritjes së tij, përfshirë institucionin që përfaqëson secili. 2. Listën e mbledhjeve/takimeve të zyrtare të zhvilluara nga Grupi i Negocimit për projekt-propozimin nga data 10 janar 2025 deri më 23 janar 2026, me: a. datën e secilit takim; b. kush kanë qenë institucionet pjesëmarrëse; c. kush kanë qenë përfaqësuesit e palës propozuese [REDACTED] 3. A ka [REDACTED] një sipërmarrës, kompani apo përfaqësues lokal të përfshirë në procesin		të Investimeve, mbetet e angazhuar për të garantuar transparencën e procesit në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore në fuqi.		
3.	30.01.2026	Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkojmë të na vini	02.02.2026	Në vijim të email-it tuaj lidhur me një kërkesë për informacion dhe sqarim mbi projekte të mundshme investimi turistik në zonën e Zvërnecit, ju informojmë se pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	E plotë	Nuk ka

		në dispozicion kopje të dokumentacionit zyrtar dhe informacionin mbi statusin (miratuar/pezulluar/refuzuar/në shqyrtim) të dosjeve të trajtuara në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) / Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU), si më poshtë: • A ka AIDA në regjistrat/dokumentacionin e saj shprehje interesi, kërkesa informacioni, aplikime, propozime investimi apo komunikime të tjera që lidhen me zhvillime turistike në Zvërnec (Vlorë)? • A ka ndonjë nga këto procese/dosje		nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë shprehje interesi, kërkesë për informacion, aplikim apo proces ndërmjetësimi nga asnjë investitor vendas apo i huaj për këtë zonë. Gjithashtu, sqarojmë se pranë AIDA-s nuk ekziston asnjë dosje, procedurë apo komunikim i çfarëdo natyre që të lidhet drejtpërdrejt osetërthorazi me znj. Ivanka Trump, përfaqësues të saj, apo kompani/partnerë të mundshëm të lidhur me të, në lidhje me investime në zonën eZvërnecit. Sa i përket kërkesës suaj për informacion mbi dosjet e trajtuara në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) / Këshillit Kombëtar tëTerritorit dhe Ujit (KKTU), ju sqarojmë se ky informacion nuk bën pjesë në kompetencat e AIDA-s.		
--	--	--	--	--	--	--

		që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi [REDACTED] përfaqësuesit e saj, kompani të lidhura me të, ose partnerë biznesi? • Nëse po, cilat janë subjektet/kompanitë e përfshira (emër i plotë, NUIS/selia kur është e mundur) dhe cili është objekti i interesit (resort, hoteleri, rezidencë turistike, infrastrukturë mbështetëse, etj.)? • Në çfarë faze ndodhen këto procese: kërkesë fillestare/shprehje interesi, shqyrtim nga AIDA, përgatitje dokumentacioni, përcjellje te institucione të tjera, aplikim për status “investitor				
--	--	---	--	--	--	--

		strategjik”, vendimmarrje, etj.? • A ka AIDA rol në lehtësimin/ndërmjetësimin institucional për këto nisma? Nëse po, cilat institucione janë kontaktuar ose përfshirë (p.sh. ministritë, Bashkia Vlorë, AKPT, AKB, AKZM, etj.)? • A ka pasur takime zyrtare (me procesverbal/shkresë) midis AIDA-s dhe përfaqësuesve të investitorëve të lidhur me këto nisma për Zvërnecin? Nëse po, kur dhe për çfarë? • A disponon AIDA dokumente shoqëruese (memo, shkresa hyrëse/dalëse, përmbledhje projekti, prezantime) që mund të bëhen				
--	--	---	--	--	--	--

		publike? Nëse ka kufizime (sekret tregtar/të dhëna personale), a mund të jepet version i redaktuar ose të paktën përshkrimi bazë i projektit dhe statusi i tij?				
4.	03.02.2026	Projekti [REDAKTUAR], projektuar nga [REDAKTUAR], në zonën e Rrjollit, i cili ka marrë lejen e ndërtimit më datë 17/12/2024, a ka marrë statusin e “investimit strategjik”? Nëse po, ju lutem më kaloni dokumentacionin i cili e provon këtë vendimmarrje! https://azht.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/HARTA-E-PLANVENDOSJES-VENDIM-NR-39-DATE-	06.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me projektin [REDAKTUAR] në zonën e Rrjollit, ju bëjmë me dije se për këtë projekt nuk rezulton asnjë vendim i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS).		

		17.12.2024.pdf?fbclid=IwY2xjawPu1pxleHRuA2FlbQIxMABicmlkETFpcEpiVFF1WUd6RXhTSkRWc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MTc4ODIwMDg5MgABHiN2jyYnBkhEONSIv3nRBnVOUIVUc0eUgRFgmJ_HhYe1a2_9YdDMAzOFdhA_aem_iaXHZrnZibp4Os-WyIrY3Q				
5	10.02.2026	Në vijim të komunikimit të mëparshëm mbi projekt-propozimin [REDACTED] Erblin Vukaj dhe redaksia e Citizens.al kërkojnë vënien në dispozicion të dokumenteve administrative konkrete që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e	13.02.2026	Në vijim të kërkesës suaj të datës 10.02.2026 , po ju përcjellim informacionin e kërkuar lidhur me ecurinëe projektit [REDACTED] Bashkëlidhur këtij komunikimi, gjeni kopje të Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike (VKIS) [REDACTED] Ju bëjmë me dije se ky është i njëjti akt që gjendet i publikuar dhe i aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare të AIDA-s. Gjithashtu, bashkëlidhur gjeni edhe Urdhrin për ngritjen e Grupit të Negocimit të Marrëveshjes (GNM). Sa i takon dokumentacionit mbi argumentimin e nevojës për shtyrjen e afatit të negociatave	E plotë	Nuk ka

		Grupit të Negocimit të Marrëveshjes.		(përtej datës 13 nëntor 2025), ju informojmë se mund ta aksesoni në faqen e website të AIDA pasi të behet publik. Ky akt do të bëjë transparent arsyetimin dhe afatet e reja zyrtare. Lidhur me pyetjet e tjera që lidhen me detajet e negociatave, të drejtat e përdorimit të territorit apo procedurat specifi ke ndërinstitucionale, ju bëjmë me dije se këto janë çështje që i përkasin fazës negociuese. Ato do të bëhen publike në momentin që do të ketë një dakordësi fi nale mes palëve, e ciladuhet t'u nënshtrohet paraprakisht të gjithë fi ltrave të vendimmarrjes përmes proceseve dhe akteve kupubliku gëzon akses të plotë ligjor.		
6.	12.02.026	A është paraqitur pranë AIDA-s ndonjë aplikim për statusin “investim strategjik” për një projekt turistik në zonën e sipërcituar në Rrjoll, Njësia Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër? Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion informacion mbi: o subjektin aplikues o datën e aplikimit o statusin aktual të aplikimit.	18.02.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, datë 12.02.2026, lidhur me një projekt turistik në zonën e Rrjollit, Bashkia Shkodër, ju bëjmë me dije se pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka pasur 11 interes të shprehur për zhvillimin e kësaj zone, por ju sqarojmë se deri në këtë moment nuk rezulton të ketë asnjë vendimarrje nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS).	E plotë	Nuk ka

		2. A është miratuar ndonjë vendim nga Komiteti i Investimeve Strategjike për këtë projekt? Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion kopje të vendimit. 3. Ju lutem na vini në dispozicion përshkrimin zyrtar të projektit, nëse ekziston, përfshirë: o sipërfaqen e parashikuar o hartën e territorit të projektit o vlerën e investimit o subjektin investitor. 4. Çfarë dokumentesh mbi pronësinë e tokës ka paraqitur subjekti aplikues në kuadër të këtij projekti? 5. Cili është statusi aktual i procedurës për këtë projekt (në shqyrtim, miratuar,				
--	--	--	--	--	--	--

		refuzuar, pezulluar, etj.)				
7.	13.02.2026	Më poshtë po ju përcjellim një kërkesë për informacion lidhur me statusin e zbatimit, fazat dhe progresin e projektit “Durrës Yachts & Marina”, në përputhje me kompetencat e institucionit tuaj.	26.02.2026	Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë se projekti “Durrës Yachts & Marina”, në kuadër të legjislacionit për investimet strategjike, AIDA ndjek zbatimin e planit të veprimit të vendimit të KIS, që ndiqet ngainsitucionet e administratës, pasi për cdo vendim të KIS, që të bëhet i ekzekutueshëm, duhet të ndiqen procedura të mëtejshme dhe verifikime/miratime kriteresh nga institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit sektorial deri në aprovimin e aktit/eve të nevojshme administrative. Në këtë kontekst për këtë projekt rezulton të ketë: • Vendimi i KIS nr. 14/6 datë 2.12.2021; • VKM nr. 861, datë 29.12.2021; • Vendimi i KIS nr. 14/45, datë 18.7.2022; • VKM nr. 494, datë 21.7.2022; • Vendimi i KIS nr. 14/61, datë 27.10.2022; • Ligj nr. 79/2022, datë 24.11.2022; • VKM nr. 115, datë 1.3.2023. Aktualisht, subjekti po vijon zbatimin e tij sipas etapave të parashikuara. Aktualisht, Faza e Parë e projektit ka hyrë në proces aktiv zbatimi, ku punimet në terren dhe lançimi i njësive po ecin sipas planifi kimit. Ky proces po kryhet në	E plotë	Nuk ka

				mënyrë graduale dhe të strukturuar, duke ndjekur afatet kohore tëpërcaktuara për të siguruar një progres të qëndrueshëm deri në finalizimin e plotë të kësaj faze.		
8.	25.02.2025	Dokumentacion administrativ lidhur me statusin e investimit strategjik të projektit turistik “Manastiri Resort”, i zhvilluar në zonën Gjiri i Manastirit, Bashkia Sarandë	26.02.2025	Në kuadër të legjislacionit për investimet strategjike, AIDA ndjek zbatimin e planit të veprimit tëvendimit të KIS, që ndiqet nga insitucionet e administratës, pasi për cdo vendim të KIS, që të bëhet iekzekutueshëm, duhet të ndiqen procedura të mëtejshme dhe verifi kime/miratime kriteresh ngainstitucionet përgjegjëse sipas legjislacionit sektorial deri në aprovimin e aktit/eve të nevojshmeadministrative. Në këtë kontekst për këtë projekt rezulton të ketë: • Vendim KIS Nr. 8/6, datë 02.12.2021; • Vendim të KKT Nr. 28, datë 28.12.2020, “Për miratim e lejes së zhvillimit për objektin “Resort Turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë”; • Vendim Nr. 9, datë 10.06.2021 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “ResortTuristik 2, 3 dhe 4 me parkime nëntokë” me vendndodhje në Bashkinë Sarandë”; • Vendim Nr. 26, datë 09.07.2024 “Për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit përobjektin “Resort Turistik 2,	E plotë	Nuk ka

				3 dhe 4 me parkime nëntokë” me vendndodhje në Bashkinë Sarandë”. Sa i përket përputhshmërisë me kriteret e legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA bën verifi kimeperiodike të dokumentacionit ligjor për projektet të cilat janë brenda afatit të statusit strategjik dhe/ose kanë një kontratë afatgjatë me autoritetin kompetent pavarësisht afatit të statusit strategjik. Sa i përket rastit në fjalë, projekti zhvillohet në pronë private dhe është i pajisur me aktet e nevojshme administrative për zhvillim/ndërtim sipas kriterëve ligjorë të legjislacionit për zhvillimin e territorit, të cilat vlerësohen nga institucionet kompetente. Aktualisht, ju bëjmë me dije se afati i statusit strategjik të këtij projekti ka përfunduar.		
9	26.02.2026	Kërkesë e deleguar nga Ministria e Financave A ka hartuar Ministria e Financave një analizë fiskale ose ekonomike për projektin “Durrës Yachts & Marina”? Nëse po, kërkojmë një kopje të saj. Cilat janë angazhimet financiare të shtetit				

		shqiptar në këtë projekt, sipas dokumenteve zyrtare në fuqi? A ekziston një dokument zyrtar që përcakton strukturën financiare të projektit? Nëse po, kërkojmë një kopje të tij				
--	--	---	--	--	--	--